

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-26-2001-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Inspektimi dhe certifikimi i vinçave**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	EALGA SH.P.K.
NUI	811862706
Adresa	Bulevardi Bill Klinton, BB 5/8 Hyrja D Nr.34
Vendi	Prishtinë,
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044296833
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ajshe Shala
Adresa elektronike	ealga.ks@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	17.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Inspektimi dhe certifikimi i vinçave

Në bazë të tenderit të publikuar: Inspektimi dhe certifikimi i vinçave. me NRP: KEK-26-2001-2-2-1, ne afatin e rregullt kohor parashtrijmë ankesë:

23.04.2026 – Njoftim për Kontrate

18.05.2026 – Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

12.06.2026 – Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues

15.06.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim

17.06.2026 – Vendim mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim

17.06.2026 – Ankesa ne OSHP

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

15.06.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim

17.06.2026 – Vendim mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit të aktiviteti të prokurimit me titull: **Inspektimi dhe certifikimi i vinçave** me NRP: **KEK-26-2001-2-2-1** nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si në vijim:

Neni 59 të LPP-së

Neni 40 të RRPP 002/2024

Neni 7 të LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1:

Autoriteti Kontraktues (AK) ka konstatuar gabimisht se dokumenti i dorëzuar nga operatori ekonomik EALGA Sh.P.K. paraqet Sigurim të Ekzekutimit dhe jo Sigurim të Tenderit (Garanci të Ofertës), siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Ky konstatim **nuk** qëndron dhe bie ndesh me përmbajtjen e vetë policës së sigurimit të dorëzuar, e cila në mënyrë të qartë dëshmon se bëhet fjalë për **Sigurim të Tenderit**. Kjo vërtetohet nga elementet e mëposhtme:

- Titulli i policës është shënuar qartë si "**Policë e Sigurimit të Garancisë së Ofertës**", çka tregon pa asnjë dyshim se dokumenti i referohet garancisë së ofertës dhe jo sigurimit të ekzekutimit të kontratës.

- Periudha e vlefshmërisë së policës është përcaktuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, përkatësisht 120 ditë. Kjo është karakteristikë e Garancisë së Ofertës, ndërsa

Sigurimi i Ekzekutimit lëshohet për periudhë tjetër, të lidhur me zbatimin e kontratës.

- Shuma e siguruar është 1,000.00 euro, saktësisht sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit për Garancinë e Ofertës. Kjo vlerë korrespondon me garancinë e kërkuar për pjesëmarrje në tender dhe jo me sigurimin e ekzekutimit të kontratës.

- Aktiviteti i prokurimit i përfshirë në policë përputhet plotësisht me aktivitetin e prokurimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, Polica e Sigurimit gjendet në faqen2 të dokumentit PDF (5_Sigurimi_Tenderit.pdf) të dorëzuar me ofertën e EALGA Sh.P.K. Nga përmbajtja e saj rezulton qartë se dokumenti është Garanci e Ofertës. Duket se Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar me kujdes këtë dokument dhe për pasojë ka arritur në një përfundim të gabuar.

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mbrymë atë
që ka vlerën!

POLICE E SIGURIMIT TE GARANCI OFERTES

Numri i serisë: BND0017261

Data e Lëshimit: 14/05/2026

Data e Fillimit: 18/05/2026

Data e Mbarimit: 15/09/2026

I Siguruar: EALGA SH.P.K.

Adresa: BULEVARDI BILL KLINTON, 88 S/S HYRJA D NR.34, PRISHTINE

Numri Unik Identifikues: 81182706

Perfituesi: KEK SH.A

Titulli i Kontrates: Inspektimi dhe kontrollimi i shpates

Numri i Prokurimit: KEK-26-2001-2-2-1

Numri i Brendshem: KKKO-26-188-221

Periudha e Sigurimit: 120 DITE

Shuma e Siguruar: 1,000.00 Njerëz Euro

Primi	TVSH	Totali	Mblyera e pageses	Data e pageses
20.00	3.60	23.60	Xhironjësi	18/05/2026

Ofertuesi e ka lehtësuar ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose për afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit.
Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme.
Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë.
Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së prokurimit në dokumentat e tenderit.

Shënime

I Siguruar: EALGA SH.P.K.

Siguruesi: Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Dega e Kosovës

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË - DREJTORIA E SHËRËS

By signing this policy the insured declares that:
-has read and accepted the general conditions as attached
-Authorizes the insurer to use and process his/her personal data necessary for the underwriting process and for settlement of the insurance claims in accordance with the legal provisions of the law in force "On the protection of the Personal data"
-has read and signed the complaining procedure attached to this policy.

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA NË KOSOVË
Aktash, Rr. Edmond Hoxha Nr.27, Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 246 301 | E-Mail: info@sigma-ks.net | Web: www.sigma-ks.net

Gjithashtu, në faqen e parë të këtij dokumenti (5_Sigurimi_Tenderit.pdf), titulli është i shënuar qartë "Siguria e Tenderit", gjë që dëshmon se dokumenti i referohet Sigurimit të Tenderit dhe jo Sigurimit të Ekzekutimit.

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGURIA E TENDERIT *Shihet qarte qe ka vlere!*

POLICA NR. BND0017261

Për: KEK S.H.A.
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues").
Në emër të:
(në vazhdim "tenderuesi") EAGLA S.H.P.K. me seli qendrore në adresën: Rr.
Bulevardi Bill Clinton, BB 5/8 Hyrja D Nr.34
(në vazhdim: "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Inspektimi dhe certifikimi i vinçave

Numri i Prokurimit: KEK-26-2001-2-2-1
Numri i Brendshëm: KEK-26-188-221

Garancia me kërkesë të parë

DERISA kontraktori i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar
Dokujes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE kontraktori obligohet të deponojë sigurinë në shumën e saktësuar sipas Dokujes së tenderit në rast që
Kontraktori dështon të përmbush obligimet sipas marrëveshjes.

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'ijapim Kontraktorit këtë siguri:

NE të poshtë nënkohërisht, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, pa asnjë kusht shtesë
përveç atyre të cekura në poshtë, deri në një total prej: 1.000.00 një mijë Euro në emër të kontraktorit në favor të
Autoritetit Kontraktues, si siguri që blerësi do përmbush të gjitha obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes, në rast
që blerësi dështon të përmbush obligimet e tij.

Ne zotohemi të ju paguajmë, shumën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, deri në maksimumin e limitit të cekur
me lart, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën ju deklaroneni

a) që bazuar në gjykimin tuaj, Kontraktori ka dështuar të përmbush obligimet kontraktuale sipas
marrëveshjes.

b) për shumën që bazuar në gjykimin tuaj Autoriteti Kontraktues kërkon të ekzekutohet nga mos përmbushja e
obligimeve kontraktuale.

Pagesa në shumën e lartshprehur prej: 1.000.00 (një mijë EURO) siguri të lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërtshim
as ankësë, sa më shpejt që është e mundur por jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës tuaj me konfirmimin "e pranimit".
Kjo siguri vlen nga data 18.05.2026 deri në datën 15.09.2026

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
DEGA KOSOVA
Sigma Vienna Insurance Group S.A. Deqa Kosovë

AKTASHI RRUGA EDMOND HOXHA NR.27 10000 PRISHTINE, REPUBLIKA E KOSOVES

A. bjo

Titulli i Polices

Shihet qarte qe nuk eshte Police e Egzekutimit!

Te dhenat e Tenderit

Shuma e Siguar

Periudha e Vlefshmerise

Është e vërtetë se në paragrafin e parë të faqes së parë gjendet një gabim teknik/administrativ, ku përmendet shprehja "siguria e ekzekutimit". Megjithatë, ky gabim i izoluar **nuk** mund të ndryshojë natyrën juridike të dokumentit dhe **nuk** mund të shndërrojë Sigurimin e Tenderit në Sigurim të Ekzekutimit. Për më tepër, të gjitha të dhënat e tjera të përfshira në faqen e parë të dokumentit janë në përputhje me kërkesat për Sigurimin e Tenderit.

Duhet theksuar se dokumenti kryesor i sigurimit është Polica e Sigurimit e paraqitur në faqen e dytë të dokumentit, e cila përcakton qartë llojin, shumën e siguruar dhe periudhën e vlefshmërisë së garancisë. Të gjitha këto elemente konfirmojnë pa mëdyshje se bëhet

fjalë për **Sigurim të Tenderit** (Garanci të Ofertës).

Prandaj, një gabim eventual teknik ose administrativ në faqen e parë **nuk** e bën të pavlefshme Policën e Sigurimit të paraqitur në faqen e dytë dhe as **nuk** mund të shërbejë si bazë për ta riklasifikuar atë si Sigurim të Ekzekutimit. Interpretimi i AK-së nuk mbështetet në përmbajtjen reale të dokumentit, e cila në tërësi dëshmon se është dorëzuar **Sigurimi i Tenderit** sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Prandaj, konsiderojmë se AK ka bërë një vlerësim të pasaktë të dokumentacionit të ofertës, duke e klasifikuar **gabimisht** Policën e Sigurimit të Garancisë së Ofertës si Sigurim të Ekzekutimit. Të gjitha elementet përmbajtësore të policës dëshmojnë qartë se ajo përmbush plotësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit për Sigurimin e Tenderit (Garancinë e Ofertës).

Në këto rrethana, kërkojmë që ky konstatim i AK-së të shpallet i gabuar dhe oferta e EALGA Sh.P.K. të rivlerësohet si e përgjegjshme duke marrë parasysh faktin se Sigurimi i Tenderit (Garancia e Ofertës) është dorëzuar në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pretendimi 2:

Autoriteti Kontraktues (AK) ka konstatuar se dokumenti i dorëzuar nga EALGA Sh.P.K. paraqet Sigurim të Ekzekutimit dhe jo Sigurim të Tenderit (Garanci të Ofertës), siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Megjithatë, ky konstatim është i pasaktë dhe bie ndesh me vetë përmbajtjen e policës së sigurimit, si dhe me sqarimet zyrtare të lëshuara nga kompania e sigurimit.

Për të eliminuar çdo paqartësi lidhur me natyrën e dokumentit të dorëzuar, EALGA Sh.P.K. ka kërkuar konfirmim nga kompania e sigurimit që ka lëshuar policën në fjalë. Kompania e sigurimit ka konfirmuar qartë se polica e lëshuar është Sigurim i Tenderit (Garanci e Ofertës) dhe nuk është Sigurim i Ekzekutimit.

Si dëshmi shtesë, kësaj ankese i bashkëngjitet sqarimi zyrtar i kompanisë së sigurimit, si në formë fotografie ashtu edhe në format PDF, ku specifikohet qartë lloji i policës së lëshuar dhe qëllimi i saj.

DEKLARATË KONFIRMIMI

Ne, të nënshkruarit, konfirmojmë se në paragrafin e parë të dokumentit në fjalë, në tekstin:

"Derisa kontraktori i lartcekur ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues"

është bërë një gabim teknik/administrativ në emërtimin e llojit të sigurisë.

Teksti i saktë duhet të jetë:

"Derisa kontraktori i lartcekur ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të tenderit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues."

Me këtë deklaratë konfirmojmë se referenca e saktë është **Siguria e Tenderit** dhe jo **Siguria e Ekzekutimit**, ndërsa të gjitha dispozitat dhe kushtet e tjera të dokumentit mbeten të pandryshuara për policën me numër BND0017261

Kjo deklaratë lëshohet për qëllime sqarimi dhe konfirmimi të të dhënave të sakta në dokumentin përkatës.

Data: 15.06.2026

Vendi: Prishtinë

Emri i Institucionit/Kompanisë: Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Dega në Kosovë

Emri dhe Mbiemri i Përfaqësuesit: Emel Thaçi

Pozita: Specialiste e Shtijes ne Departamentin e shitjes

Nënshkrimi dhe Vula:



Ky konfirmim nga vetë institucioni që ka lëshuar policën përbën provë të drejtpërdrejtë dhe autentike mbi natyrën e dokumentit, duke vërtetuar se policia e dorëzuar nga EALGA Sh.P.K. është në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit për Garancinë e Ofertës.

Prandaj, konsiderojmë se AK nuk e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e dorëzuar dhe si rezultat e ka klasifikuar **gabimisht** policën si Sigurim të Ekzekutimit. Të gjitha provat e paraqitura, përfshirë vetë policën dhe konfirmimin zyrtar të kompanisë së

sigurimit, dëshmojnë qartë se bëhet fjalë për **Sigurim të Tenderit**, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në këto rrethana, kërkojmë që ky konstatim i AK-së të shpallet i gabuar dhe oferta e EALGA Sh.P.K. të rivlerësohet si e përgjegjshme duke marrë parasysh faktin se Sigurimi i Tenderit (Garancia e Ofertës) është dorëzuar në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Perfundim:

Duke u bazuar në dëshmitë mbi shkeljet ne pikat ankimore të lartpërmendura kërkojmë nga **OSHP** që të marr:

VENDIM

ANULOHET - Njoftimi mbi vendimin e AK-se lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit me nr Prokurimit: **KEK-26-2001-2-2-1** dhe titull: **Inspektimi dhe certifikimi i vinçave** të inicuar nga AK **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES SH.A.**

APROVOHET:

Ankesa si e Bazuar dhe lënda: **KTHEHET NE RI VLERESIM DHE VLERESIMI TE BEHET NE PERPUTHJE ME RRPP 002/2024 DHE LPP.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e shkaktuara janë shpenzimet në përgatitjen e ofertës, dëme në reputacion dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*